



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 1606 Prot

Shkodër, më 25.01.2024

Lënda: Dërgohet për shqyrtim relacioni dhe projekt-vendimi “Për një shtesë plani dhe ndryshim në buxhetin e bashkisë shkodër për “Projektin Hold On - Nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë”.

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin: “Për një shtesë plani dhe ndryshim në buxhetin e bashkisë shkodër për “Projektin Hold On - nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë”.

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

Benet Beci

ME VENDIM DELEGIMI



Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KRYETAR**

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ .2024

“Për një shtesë plani dhe ndryshim në buxhetin e bashkisë shkodër për “Projektin Hold On - Nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë”.

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar ; nenit 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore”, i ndryshuar ; të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; pika 190 e udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, udhëzimit nr.35, datë 21.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, të ndryshuar; Rezoluta e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara e datës 04.12.2017. Marrëveshja e programit Erasmus+ 2021-2027 e miratuar ndërmjet Agjencisë Kombëtare dhe Bashkisë Shkodër, ku Bashkia Shkodër ka rolin e palës zbatuese për zbatimin e Projektit “HOLD ON - Nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë” me nr.20713 Prot, datë 29.12.2023; VKB Nr. 55, Datë 29.12.2023 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2024 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër", pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga Administrata e Bashkisë.

VENDOSI:

1. Të miratojë shtesën e planit dhe ndryshimin në buxhetin e Bashkisë Shkodër për projektin “HOLD ON - Nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë”, financuar në kuadër të programit “Erasmus+”, i financuar nga Agjencia Kombëtare Franceze për të mbështetur projekte në fushën e rinisë dhe sporteve, në

programin Erasmus+ 2021-2027, në shumën 27562.00 EURO, e konvertuar në 2,869,000 LEK.

- Kontributi i Bashkisë Shkodër do të jetë mbulimi i vlerës së TVSH 20% me vlerë 435,000 Lek. Ky kontribut do të merret nga tepricat e programit 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët” të vitit 2023.
- Projekti do të zbatohet me llogari brenda thesari dhe do të përfshihet në programin 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët” sipas tabelës së mëposhtme dhe fishës bashkëlidhur.

Shpenzimet e llogaritura				
Shpenzimet për çdo aktivitet	Totali	Nga kjo:		
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzim e Operative
Shuma 2024	2,816,000	550,000	92,000	2,174,000
Shuma 2025	53,000	45,000	8,000	
Shuma totale e Projektit e financuar nga Projekti	2,869,000	595,000	100,000	2,174,000
Bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër	435,000			435,000
Totali	3,304,000	595,000	100,000	2,609,000

- Miratimin e shtesës së numrit të punonjësve dhe miratimin e nivelit të pagës për punonjësit e planifikuar me fondet e projektit për vitin 2024 dhe 2025.

Projekti ka parashikuar të punësojë një punonjës në rolin specialist - Koordinator Projekti sipas angazhimit: 12 muaj në vitin 2024 dhe 1 muaj në vitin 2025.

Fondi i përllogaritur është marrë nga buxheti i projektit dhe shpenzimi mbulohet nga donatori.

Niveli i pagës do të jetë sipas tabelës së mëposhtme:

Emërtimi	Punonjës	I zgjedhur, I emëruar	Arsimi i lartë		Arsimi i mesëm	
			Kategoria	Pozicioni	Klasa	Paga Bazë Mujore
Specialist	1		IV-a	56,000		
Numri i Punonjësve	1					

Punonjësi do punojë me kohë të pjesshme me 60% të kohës përgjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.

- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet Beci

**ME VENDIM DELEGIMI
ZV/KRYETAR**

Onid Bejlari

Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit

Arxno Berdele

*Drejtoria e Analizës dhe
e Programimit Buxhetor*

*Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe
Shërbimeve Mbështetëse*

Arxhile Peraj

Drejtoria Juridike

Zedraza Lajçaj

Drejtoria e Financës

Blerta Mjole



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2024

RELACION

~~“PËR NJË SHITËSË PLANI DHE NDRYSHIM NË BUXHETIN E BASHKISË SHKODËR PËR “PROJEKTIN HOLD ON - NXITJA E AKSESIT NË MBËSHËTJETEN E SHËNDETIT MENDOR PËR TË RINJTË”.~~

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Shkodër

Të nderuar Këshilltarë!

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar ; nenit 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore”, i ndryshuar ; të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; pika 190 e udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, udhëzimit nr.35, datë 21.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, të ndryshuar; Rezoluta e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara e datës 04.12.2017. Projekti mbështet zbatimin e vizionit të sektorit social në Shqipëri, në përputhje me Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG-të) dhe aspiratat e vendit drejt integritimit evropian. Qëllimi i projektit është përmirësimi i aksesit e të rinjve në shërbimet mbështetëse të shëndetit mendor dhe angazhim proaktiv i tyre në përmirësimin e rezultateve të shëndetit mendor; Marrëveshja e programit Erasmus+ 2021-2027 e miratuar ndërmjet Agjencisë Kombëtare dhe Bashkisë Shkodër, ku Bashkia Shkodër ka rolin e palës zbatuese për zbatimin e Projektit “HOLD ON - Nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë”, me Nr. 20713 Prot, datë 29.12.2023; “VKB Nr. 55, Datë 29.12.2023 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2024 dhe Programit

Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër", pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga Administrata e Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, ju dërgojmë këtë relacion "Për miratimin e shtesës së fondeve në buxhetit të Bashkisë së Shkodrës" për Projektin "HOLD ON - Nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë".

Projekti: "HOLD ON - Nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë" është shpallur fitues në kuadër thirrjes për projekte "Erasmus+", një program i Bashkimit Evropian, i financuar nga Agjencia Kombëtare Franceze e rinisë dhe sportit.

Propozimi për nxitjen e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë në territorin e Bashkisë Shkodër vjen si nevojë për rritjen e shërbimeve të shëndetit mendor për këtë kategori. Qendra rinore "Atelie" dhe Qendra Multifunksionale "Xixëllonjat" është ambjent i përshtatshëm për zbatimin e projektit "Hold On", me synim zhvillimin dhe fuqizimin e shërbimeve jo formale mbështetëse të shëndetit mendor për të rinjtë në komunitet.

Në përputhje me objektivat e Strategjisë së BE-së për Rininë për 2019-2027, projekti HOLD ON do të çojë në përmirësimin tek të rinjtë të ndjenjës së iniciativës së njerëzve dhe mundësive për pjesëmarrjen e tyre qytetare përmes angazhimit vullnetar në mbështetje të bashkëmohatarëve. Projekti përfshin elementë të fuqishëm të qytetarisë aktive dhe solidaritetit, pasi synon të frymëzojë të rinjtë të marrin kontrollin e jetës së tyre dhe angazhohen dhe mbështesin të tjerët. Domethënë, do të nxisë përfshirjen kuptimplotë të të rinjve në zhvillimin e shërbimeve holistike të shëndetit mendor dhe mirëqenies në përshtatje me nevojat e tyre.

Kriza e COVID-19 është lidhur me përkeqësimin e shëndetit mendor dhe mirëqenies tek të rinjtë, dhe si rrjedhojë komuniteti ka nevojë për plotësimin dhe ofrimin e shërbimeve specifike për të rinjtë. Nëpërmjet vullnetarizmit dhe ofrimit të mbështetjes së bashkëmohatarëve, të rinjtë mund të luajnë një rol të rëndësishëm në adresimin e kësaj nevoje urgjente shoqërore. Aktivitetet që përfshin projekti ndër të tjera, do të inkurajojnë dhe do pajisin të rinjtë me burimet e nevojshme që do t'i mundësojnë atyre të kryejnë këtë rol. Projekti HOLD ON do të krijojë vlerë dhe dobi për të rinjtë në aspektin e njohurive, përvojës dhe vetëvlerësimit.

Kuadri ligjor:

Ky projekt do të zbatohet në mbështetje të:

- Ligji nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë"
- Planin Social Vendor të Bashkisë Shkodër 2018– 2021 Vendim nr. 84 , datë 20.12.2018.
- Rezolutës së miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, e datës 04.12.2017.

- Marrëveshja standarte mes Programit Erasmus+ dhe Bashkisë Shkodër për zbatimin e Projektit “HOLD ON - Nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë”, me Nr. 20713 Prot, datë 29.12.2023.

Kuadri i përgjithshëm:

HOLD ON do të kontribuojë në rritjen e aksesit të të rinjve në shërbimet joformale të shëndetit mendor të bashkëmoshatarëve në pika shërbimi që nuk ofrohet shërbimi mjekësor, siç janë institucionet arsimore, organizatat rinore, qendrat e punës, qendrat sportive dhe qendrat kulturore, duke siguruar që të arrihen të rinjtë më vulnerabël.

Për më tepër, do të kontribuojë në përmirësimin e shëndetit mendor, ofrimin e trajnimeve dhe burimeve për profesionistët që punojnë me të rinjtë, por nuk lidhen me shëndetësinë, në menyrë që të rinjtë të njohin problemet e shëndetit mendor dhe të krijojnë mjedise mbështetëse për ofrimin e mbështetjes joformale të bashkëmoshatarve të tyre.

Projekti do të rrisë ndërgjegjësimin e publikut të gjerë për mirëqenien mendore të të rinjve. Projekti synon që perfituesit të jenë rinjtë e moshës 14-29 vjeç, si dhe profesionistët që punojnë me të rinjtë.

Në këtë kuadër, **qëllimi i përgjithshëm** i projektit është: Përmirësimi i aksesit e të rinjve në shërbimet mbështetëse të shëndetit mendor dhe angazhimi proaktiv i tyre në përmirësimin e rezultateve të shëndetit mendor.

Buxheti i Projektit:

Buxheti i Projektit për Bashkinë Shkodër do të jetë 3,304,000 LEK në total për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit, ku përfshihet pjesa e financuar nga Programi dhe bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër për projektin:

- Buxheti i financuar nga Programi për Bashkinë Shkodër do të jetë 27562.00 euro, i konvertuar në 2,869,000 Lek (86.83%) për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit.
- Bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër për Projektin do të jetë 435,000 Lekë (13.17%), për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit. Ky kontribut do të merret nga tepricat e programit 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët” të vitit 2023.

Vlerësojmë të rëndësishme të nënvizojmë që Bashkia Shkodër do të aplikojë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për rimbursimin e vlerës së TVSH-së.

Financimi do të bëhet në 3 këste: Kësti i parë me vlerë 11,024.8 Euro, i cili do të kalojë pas nënshkrimit të marrëveshjes sipas nenit 6, pika 2; Kësti i dytë 11,024.8 Euro pas miratimit të raportit të ndërmjetëm dhe kësti i tretë 5,512.4 Euro pas miratimit të raportit përfundimtar.

Objektivat e projektit:

OS.1: Forcimi dhe inkurajimi i të rinjve që të mbështesin të tjerët, në kalimin e sfidave të tyre të shëndetit mendor, nepërmjet krijimit të shërbimeve joformale mbështetëse.

OS.2: Pajisja e profesionistëve që punojnë me të rinjtë me njohuri dhe aftësi të nevojshme për të krijuar mjedise mbështetëse dhe ofrimi i shërbimeve joformale të shëndetit mendor për të rinjtë.

OS.3: Nxitja e shkëmbimit të praktikave të mira në shërbimet mbështetëse të shëndetit mendor të të rinjve dhe nxitja e politikave më të mira, ndaj nevojave të shëndetit mendor të të rinjve.

OS.4: Rritja e ndërgjegjësimit për shëndetin mendor të të rinjve dhe rëndësia e reagimit të komunitetit.

Aktivitetet kryesore të projektit:

Aktiviteti 1: Dizajnimi dhe zhvillimi i kursit e-learning.

Aktiviteti 2: Pilotimi dhe finalizimi i kursit e-learning.

Aktiviteti 3: Programi i mentorimit.

Aktiviteti 4: Organizimi i konferencës ndërkombëtare.

Rezultatet kryesore të pritshme të projektit:

Rezultati 1:

- Kurs gjithëpërfshirës e-learning për advokues të shëndetit mendor të të rinjve - të rinjtë me përvojë në fushën mendore dhe sfidat shëndetësore dhe/ose me interes për shëndetin mendor dhe promovimin e mirëqenies.
- Programi i mentorimit të avokatëve të shëndetit mendor të të rinjve të interesuar në krijimin e grupeve mbështetëse të shëndetit mendor bashkëmoshatar.
- Konferenca ndërkombëtare e avokatëve të shëndetit mendor të të rinjve.

Rezultati 2:

- Raporti i njohurive mbi faktorët kryesorë që ndikojnë në përfshirjen e profesionistëve në mbështetjen e shërbimeve të shëndetit mendor të të rinjve.

- Doracak për profesionistët për mbështetjen e të rinjve në ofrimin e shërbimeve mbështetëse për shëndetin mendor.
- Ditët kombëtare të “Matchmaking” që stimulojnë bashkëpunimin mes të rinjve dhe profesionistëve.

Rezultati 3:

- Platformë shkëmbimi ku të rinjtë dhe profesionistët mund të shkëmbejnë përvojat dhe praktikat më të mira në shëndetin mendor të të rinjve.
- Politikat dhe dokumenti i rekomandimeve, duke përfshirë hartimin e palëve të interesuara dhe rekomandimet për forcimin e reagimit për shëndetin mendor të të rinjve.

- Aktivitetet kombëtare të advokimit duke përfshirë të rinjtë, profesionistët dhe politikëbërësit.

Rezultati 4:

- Strategjia dhe plani i gjerë i shpërndarjes dhe shfrytëzimit duke detajuar aktivitetet për të siguruar ndikimin maksimal të projektit aktivitetet dhe dukshmëria dhe shpërndarja efektive e rezultateve të projektit.
- Materialet dhe aktivitetet e ngritjes së ndërgjegjësimit dhe shpërndarjes (logoja e projektit, identiteti vizual, uebsajti i projektit, llogari në rrjete sociale, njoftime për shtyp, fletëpalosje dixhitale, infografikë, ngjarje shumëzuese).

K R Y E T A R

Benet Beci

**ME VENDIM DELEGIM
ZV/KRYETAR**

Onid Bejleri

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik

Nr. 41	Projekti: P10430. Q4.02.A14	Funksioni: 10: MBROJTJA SOCIALE
	"Projekti HOLD ON - Nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë" - 2022-2-FR02-KA220-YOU-000096911	N/Funksioni 104: Familja dhe fëmijët
		Lloji i veprimit: KA220-YOU- Partneritetet e bashkëpunimit tek të rinjtë
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
Kuadri i përgjithshëm:		
Bashkia Shkodër është shpallur fituese në projektin "Projekti HOLD ON - Nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë" në kuadër të thirrjes për projekte të programit Erasmus+, i financuar nga Agjencia Kombëtare Franceze. Nëpërmjet këtij projekti synohet akses i të rinjve në shërbimet joformale të shëndetit mendor të bashkëmoshatarëve në pika shërbimi që nuk ofrohet shërbimi mjekësor, siç janë institucionet arsimore, organizatat rinore, qendrat e punës, qendrat sportive dhe qendrat kulturore, duke siguruar që të arrihen të rinjtë më vulnerabël.		
Projekti do të risë ndërgjegjësimin e publikut të gjerë për mirëqenien mendore të të rinjve. Projekti synon që perfutuesit të jenë rinjtë e moshës 14-29 vjeç, si dhe profesionistët që punojnë me të rinjtë.		
Kuadri ligjor:		
Ky projekt do të zbatohet në mbështetje të: - Ligji nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë" - Planin Social Vendor të Bashkisë Shkodër 2018– 2021 Vendim nr. 84 , datë 20.12.2018. - Rezolutës së miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, e datës 04.12.2017. - Marrëveshja standarte mes Programit Erasmus+ dhe Bashkisë Shkodër për zbatimin e Projektit "HOLD ON - Nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë", me Nr. 20713 Prot, datë 29.12.2023.		
Projekti Nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë", financuar në kuadër të programit "Erasmus+", i financuar nga Agjencia Kombëtare Franceze për të mbështetur projekte në fushën e rinisë dhe sportive, në programin Erasmus+ 2021-2027, shuma është 2,869,000 LEK.		
Kontributi i Bashkisë Shkodër do të jetë mbulimi i vlerës së TVSH 20% me vlerë 435,000 Lek.		
ii. Synimi i projektit		
Qëllimi i përgjithshëm i projektit është: Përmirësimi i aksesit të të rinjve në shërbimet mbështetëse të shëndetit mendor dhe angazhim proaktiv të tyre në përmirësimin e rezultateve të shëndetit mendor.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
Aktiviteti 1: Dizajnimi dhe zhvillimi i kursit e-learning.		
Aktiviteti 2: Pilotimi dhe finalizimi i kursit e-learning.		
Aktiviteti 3: Programi i mentorimit.		
Aktiviteti 4: Organizimi i konferencës ndërkombëtare.		
b) Rezultatet që prisni		
Rezultati 1:		
<ul style="list-style-type: none"> • Kurs gjithëpërfshirës e-learning për advokuesit e shëndetit mendor të të rinjve - të rinjtë me përvojë në fushën mendore dhe sfidat shëndetësore dhe/ose me interes për shëndetin mendor dhe promovimin e mirëqenies. • Programi i mentorimit të avokatëve të shëndetit mendor të të rinjve të interesuar në krijimin e Grupeve Mbështetëse të Shëndetit Mendor bashkëmohatar. • Konferenca ndërkombëtare e avokatëve të shëndetit mendor të të rinjve. 		
Rezultati 2:		
<ul style="list-style-type: none"> • Raporti i njohurive mbi faktorët kryesorë që ndikojnë në përfshirjen e profesionistëve në mbështetjen e shërbimeve të shëndetit mendor të të rinjve • Doracak për profesionistët për mbështetjen e të rinjve në ofrimin e shërbimeve mbështetëse për shëndetin mendor • Ditët Kombëtare të "Matchmaking" që stimulojnë bashkëpunimin mes të rinjve dhe profesionistëve. 		
Rezultati 3:		
<ul style="list-style-type: none"> • Platformë shkëmbimi ku të rinjtë dhe profesionistët mund të shkëmbejnë përvojat dhe praktikat më të mira në shëndetin mendor të të rinjve • Politikat dhe dokumenti i rekomandimeve, duke përfshirë hartimin e palëve të interesuara dhe rekomandimet për forcimin reagimi për shëndetin mendor të të rinjve. • Aktivitetet kombëtare të advokimit duke përfshirë të rinjtë, profesionistët dhe politikëbërësit 		
Rezultati 4:		
<ul style="list-style-type: none"> • Strategjia dhe plani i gjerë i shpërndarjes dhe shfrytëzimit duke detajuar aktivitetet për të siguruar ndikimin maksimal të projektit aktivitetet dhe dukshmëria dhe shpërndarja efektive e rezultateve të projektit • Materialet dhe aktivitetet e ngritjes së ndërgjegjësimit dhe shpërndarjes (logoja e projektit, identiteti vizual, uebsajti i projektit, llogari në rrjete sociale, njoftime për shtyp, fletëpalosje dixhitale, infografikë, ngjarje shumëzuese) 		
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt

- Autoritetet vendore & lokale;
- Nëpunësit e qeverisjes lokale,
- Organizatat e shoqërisë civile,
- Media lokale,
- Komuniteti në përgjithësi.

Agjencia Kombëtare Franceze,
Komisioni Bashkimit Evropian

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (000 lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime shoq + shend.	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale
A.1	Paga dhe sigurime për projektin (1 punonjës)	642	550	92		
A.2	Shërbime përkthimi	171			171	
A.3	Udhëtime	177			177	
A.4	Organizim aktivitetesh (Blerje materiale promocionale, refreshment)	396			396	
A.5	Ekspertizë dizajn/ zhvillim e- learning platform	191			191	
A.6	Ekspertizë pilotim/ testim e-learning platform	46			46	
A.7	Ekspertizë mentorim	168			168	
A.8	Ekspertizë për konferencën	54			54	
A.9	Ekspertizë për mentorim programi	103			103	
A.10	Ekspertizë përgatitje raporti	245			245	
A.11	Ekspertizë zhvillimi handbook	191			191	
A.12	Ekspertizë mbështetje stafi	76			76	
A.13	Ekspertizë teknike	130			130	
A.14	Ekspertizë pilotim/ testim/ update platformë	38			38	
A.15	Ekspertizë hartim dokumenti/ rekomandimesh	76			76	
A.16	Ekspertizë advokacie	61			61	
A.17	Ekspertizë komunikimi	8			8	
A.18	Përkthim Eëbsite	43			43	
A.19	Vlera e bashkëfinancimit me fondet e bashkisë për TVSH-në	435			435	
Shuma		3,251	550	92	2,609	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (000 lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime shoq + shend.	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale
A.1	Paga dhe sigurime për projektin (1 punonjës)	53	45	8		
Shuma		53	45	8		

f) Periudha e zbatimit 2024-2025	g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik Institucioni Ilkujdues: Bashkia Shkodër
--	--